

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Bëmë takim familjar"-Flet Ziza Pajaziti: Ja si hyra dy herë në burg për takim me Laert Haxhiun
ADRESA	https://piranjat.al/aktualitet/beme-takim-familjar-flet-ziza-pajaziti-ja-si-hyra-2-here-ne-burg-per--i103801
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	12 shtator 2026, 13:23:49 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	12 shtator 2026, 13:18:37 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f7f9e8bb4f6c6844507609250a85169f0de904521406c63f8282be549f245863
TEKSTI	380a62dc16439204d4e67aab26b17d16c968db08b995fc55bdd20a75907b8fda
PAMJA	9b4782530c8f4dc1471a77dbcf331f18aa8254275ea4a64595456a440bd5b57c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9dfe04579cb962264eff7ccc0ef9bf78f302fa70c2ef5cf36f1fe933ab5e5f6f
E MËPARSHMJA	107a87ca259e4324a17d772a09c14c038e36be48d9887457f1a3e0226f0d8eb2
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9dfe04579cb962264eff7ccc0ef9bf78f302fa70c2ef5cf36f1fe933ab5e5f6f>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- EDITORIAL
- EMISIONE
- INVESTIGIME
- AKTUALITET
- SOCIALE
- POLITIKË
- KOSOVA
- BOTA
- SHOWBIZ
- LIFESTYLE
- SPORT

SYRI LIVE



Flash: **rugët** shkaktoar grumbullime t&eum... **■** **rugën dhe largohet me** kundër Reformës Administrative-Territoriale **■** **dy here në burg në burg** rezultoni të ketë hyrë në ambientet e **■** **te krimeve të luftës izraelite** si një model të shkeljeve të t&eu... **■** **kush mban përgjegjësi në vendin tonë.** **■** **nip** mli I p

AKTUALITET

"Bëmë takim familjar"-Flet Ziza Pajaziti: Ja si hyra dy herë në burg për takim me Laert Haxhiun

Nga Elton Qyno Përditësimi i fundit 12 Shtator 2026, 15:18



"Bëmë takim familjar"-Flet Ziza Pajaziti: Ja si hyra dy

Modelja kosovare Ziza Pajaziti, e cila në datat 12 dhe 13 qershor 2025 rezultoi të ketë hyrë në ambientet e burgut të sigurisë së lartë të Drenovës në Korçë, ka dëshmuar të gjithë dinamikën që ka sjellë futjen e saj në burg, me qëllim zhvillimin e një takimi me të dënuarin me burgim të përjetshëm, Laert Haxhiu.

Pyetja e Pajazitit është bërë në Prokurorinë e Korçës, e cila ka ndjekur rastin hetimor kundër një gardiani burgu, Perent Lëngut, dhe ish-shefit të Policisë së Burgut të Drenovës, Sokol Koçellit.

Gjatë hetimit të kësaj dosjeje penale, prokuroria nuk mundi të marrë pamjet filmike të plota, pasi, sipas një shkrese "Kthim Përgjigje" nga drejtoria e burgut, materialet filmike të datave 12 dhe 13 qershor 2025 nuk gjendeshin në serverin kompjuterik, pasi ato ruhen vetëm brenda një periudhe 7-ditore dhe më pas fshihen automatikisht.

Në pamundësi për të zbuluar të gjithë dinamikën përmes kamerave të sigurisë, Prokuroria e Korçës është përqendruar tek marrja e dëshmisë së disa prej gardianëve të burgut, si dhe pyetja e vetë protagonistëve kryesorë, Laert Haxhiu, Vladimir Kurti dhe modeles kosovare, Ziza Pajaziti.

Në rrëfimin e saj të dhënë në prokurori, Ziza Pajaziti ka dëshmuar se:

"...aktualisht jam e punësuar pranë "Well Farmaci", në pozicionin e menaxheres së marketingut në qytetin e Prishtinës, Kosovë. Kjo është puna ime e dytë, pasi punën kryesore e kam modelingun. Në lidhje me ngjarjen për të cilën jam paraqitur dhe po jap shpjegimet e mia, pra takimet që kam zhvilluar me të dënuarin Laert Haxhiu në datat 12 qershor 2025 dhe 13 qershor 2025, ditën e enjte dhe ditën e premte, dua të sqaroj se unë dhe Laert Haxhiu kemi pasur një marrëdhënie të qëndrueshme bashkëjetese. Këtë marrëdhënie e kemi formalizuar me dokumente, konkretisht me Marrëveshjen e Bashkëjetesës, të lidhur para noterit Bledar Zake në datën 6 tetor 2025. Në datën 12 qershor 2025 kam shkuar për të takuar bashkëjetuesin tim në burgun e Drenovës. Pasi jam paraqitur në hyrje, në postoblok, më kanë pyetur se kë do të takoja dhe unë kam dhënë emrin e bashkëjetuesit tim, Laert Haxhiu. Pas kësaj më kanë pajisur me një fletë të vogël, të cilën nuk e kam lexuar për të parë se çfarë përmbante. Kam lënë sendet personale në kasafortat e sigurisë dhe më pas kam vazhduar drejt një godine në brendësi të burgut, ku iu nënshtrua kontrollit personal..."

Më tej, Ziza Pajaziti ka dëshmuar se ka vazhduar drejt dhomës së takimeve, duke kaluar nëpër një korridor, vendndodhjen e të cilit nuk e mbante mend me saktësi.

"...atje jam shoqëruar nga një punonjës policie dhe, më pas, në të njëjtën dhomë është shoqëruar edhe bashkëjetuesi im, Laert Haxhiu, me të cilin kam zhvilluar një takim normal familjar. Atë ditë kam qëndruar në qytetin e Korçës dhe të nesërmen, pra në datën 13 qershor 2025, kam shkuar përsëri në burgun e Drenovës. Kam ndjekur të njëjtën procedurë që shpjegova më sipër dhe, edhe këtë herë, në postoblok kam dhënë emrin e Laert Haxhiut. Unë nuk dija asnjë emër tjetër të ndonjë personi të dënuar dhe dua të theksoj se jam plotësisht e sigurt se nuk kam dhënë asnjë emër tjetër përveç emrit të Laert Haxhiut. Nuk e di se çfarë lapsusi mund të ketë ndodhur, siç kam lexuar më pas në media. Më pas kam vazhduar procedurën e kontrollit dhe të hyrjes në dhomën e takimeve, ku edhe këtë herë jam shoqëruar në një dhomë me tavolinë dhe karrige, ku kemi zhvilluar një takim të zakonshëm dhe jo takim special, siç është shkruar në media, gjë që më ka habitur shumë. Pasi kam qëndruar për një kohë, të cilën nuk e mbaj mend, kam dalë nga ambientet e Burgut të Drenovës dhe jam larguar..." -ka treguar në prokurori Ziza Pajaziti.

Modelja kosovare ka dëshmuar se nuk ka shkuar më ta takojë Laertin në burg, për shkak të publicitetit që mori ky rast dhe për shkak të gjendjes së rënduar psikologjike që ka përjetuar si pasojë e ekspozimit publik të jetës së saj private.

Ndërkohë, lidhur me këtë rast, në vijim të veprimeve hetimore, konkretisht është pyetur, në cilësinë e personit që tregon rrethana të dobishme për veprën penale, i dënuari me burg përjetë Laert Haxhiu, i cili, ndër të tjera, ka deklaruar se:

"...në lidhje me rrethanat se si ka hyrë Ziza Pajaziti për të më takuar mua, unë nuk di asgjë për procedurat që ndjek administrata e burgut në raste të tilla. Në dijeninë time, kjo shtetase, në datat për të cilat po më pyesni, ka hyrë normalisht, ashtu si çdo shtetase apo shtetase tjetër që zhvillon takime me familjarët. Mua nuk më ka kontaktuar paraprakisht asnjë punonjës i burgut, por vetëm më kanë shoqëruar në këto dy data për të realizuar takimin. Dua të sqaroj se, në të dyja këto data, kam hyrë në takim, pasi më është njoftuar se kisha takim dhe më kanë shoqëruar për zhvillimin e tij. Në të dyja këto raste, takimet e zhvilluara prej meje kanë qenë takime të zakonshme, pra në një dhomë me tavolinë dhe karrige, dhe jo takime speciale, pra takime të parashikuara për bashkëshortët ose bashkëjetuesit. Nuk e mbaj mend nëse dhomat kanë qenë të pajisura me kamera apo jo, pasi mbaj mend se në atë periudhë dhomat ishin duke u rikonstruktuar, konkretisht po lyheshin..."

Më tej, Haxhiu ka pohuar se: "...dua të theksoj se çdo gjë ka qenë e zakonshme dhe kam zhvilluar vetëm takime normale me Ziza Pajazitin, e cila aktualisht është bashkëjetuesja ime, me deklaratë noteriale të rregullit, dhe me të cilën kam pasur një marrëdhënie të hershme njohjeje dhe bashkëjetese..."

Lidhur me këtë skandal është marrë në pyetje dhe i dënuari Vladimir Kurti, i cili ka pohuar se:

"...modelen kosovare Ziza Pajaziti nuk e njoh dhe nuk kam realizuar asnjë takim me këtë shtetase. Gjithashtu, nuk kam kërkuar takim me të. Deklaroj se kam rreth 4 muaj që nuk zhvilloj takime familjare..."

Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 12 Shtator15:04

Emigrantët sjellin më shumë para. Banka e Shqipërisë: 621 milionë euro në 6 muaj

Dërgesat e emigrantëve drejt Shqipërisë kanë vijuar rritjen, duke shënuar një tjetër rekord. Vetëm gjatë gja...

AKTUALITET 12 Shtator15:00

Stuhia e fortë përfshin Roskovecin, pemët e thyera pengojnë qarkullimin

Një stuhi e fortë ka përfshirë mesditën e sotme qytetin e Roskovecit dhe fshatrat përreth. Stuhia ka zgjatur rreth 10 minuta, n...

AKTUALITET 12 Shtator14:39

EMRAT/ Katër elektrikistë të vdekur në pak muaj, kush mban përgjegjësi për sigurinë në terren?

Një tjetër rast ku një elektrikist humb jetë gjatë punës është regjistruar në vendin tonë. Ngjarja k...

AKTUALITET 12 Shtator14:18

SHBA zyrtarizon huanë 302 milionë dollarë për Shqipërinë, Nufi: Konfirmim i besimit

Agjencia amerikane për Bashkëpunimin në Sigurinë e Mbrojtjes (DSCA) ka zyrtarizuar marrëveshjen për një hua direkte prej 30...

AKTUALITET 12 Shtator13:37

Durrës/ Qarkullonte me pistoletë, arrestohet Haki Koka, nipi i ish-ministrit Lefter Koka

Haki Koka, nipi i ish-ministrit Lefter Koka, është arrestuar në Durrës gjatë operacionit policor "Informacioni", pasi dys...

AKTUALITET 12 Shtator13:31

EMRAT/ Vrau bashkëmoshatarin, dënohet me 12 vite burg 15-vjeçari

Është dënuar me 12 vite burgim Enedjos Guri, 15-vjeçari që 1 vit më parë vrau me thikë në fshatin Pirg të ...

AKTUALITET 12 Shtator12:49

Nafta prek 229 lekë, por qeveria nuk heq dorë nga akciza: Shtrenjtimi rëndon qytetarët

Çmimi i naftës dhe benzinës në tregun vendas po i afrohet niveleve rekord të shënuara gjatë luftës në Ukrain&eu...

AKTUALITET 12 Shtator12:43

Përplasje me policinë gjatë protestës kundër ndërtimit të Muzeut Hebraik në Vlorë

Dhjetëra qytetarë janë mbledhur përpara zonës ku po ndërtohet Muzeu Hebraik në Vlorë, duke protestuar dhe kundërs...

AKTUALITET 12 Shtator12:32

Arratisja spektakolare nga spitali grek/ Gentian Çipi rezulton i kërkuar në Shqipëri

41-vjeçari Gentian Çipi, i arratisur mbrëmjen e djeshme nga një spital në Greqi, rezulton person në kërkim në Shqi...

AKTUALITET 12 Shtator12:19

Ra në kontakt me rrymën elektrike gjatë punës, humb jetën elektrikisti i OSHEE

Një ngjarje e rëndë është regjistruar paraditen e sotme në fshatin Trojas, ku një 32-vjeçar, punonjës i OSHEE-s...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 11 Shtator

EMRAT/ Vrasja e Ferdinand Hotit në Itali, kush ...

Hetimet për vrasjen e Ferdinand Hotit, 35 vjeç, shqiptarit me banim në Mirano, po përqendrohen në botën e trafikut të drog&...

SHOWBIZ 11 Shtator

VIDEO/ Dalin pamjet, ky është i dashuri i Franç...

Gazetari Elton Tozaj ka rikthyer sërish në vëmendje jetën private të personazheve të showbiz-it. Këtë herë, n&eu...

AKTUALITET 12 Shtator

Pritë me armë në Greqi, 'policët' e rremë bllok...

Një arratisje spektakolare ka ndodhur mbrëmjen e së premtes në Greqi, gjatë transferimit të një të burgosuri nga Burgu...

INVESTIGIME 31 Maj14:01

Gratterit për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antidrogras, Ivicola Gratteni, ka qenë nën hijen e kercenimeve...

video



Reagon Clevio!



Reagon Clevio!



Matilda,Piranjja jonë vegjetariane: gjatë javës kap të korruptuarit, të dielën thyen rekorde në male!



Deklarata e Gjestit!



7 September 2026



Pamje apokaliptike nga Puka!



7 September 2026



Aida, piranja jonë e parë, rikthehet në skuadër më e motivuar se kurrë për të kapur maniakët.



Qytetarët na frymëzojnë çdo ditë. Bisedat e mikpritja e tyre na japin motiv për punën me pasion.



Luela Gaxhja, “stari” i Piranjave, që kërkon çdo ditë rritje rroge.



5 September 2026



5 September 2026



Florjan Binaj rikonfirmon: Do kandidoj sërish si kandidat i pavarur



Edon Kuqi/Piranja jonë politike që ngatërroi ëndrrën e gazetarit me atletin 100m.



Dyshime për zjarrvënien të qëllimshme



Humbi jetën në aksidentin tragjik, një muaj më parë i propozoi për martesë.



Qytetarja denoncon me video ngacmimin ne autobus. #news



Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave



PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 16



Gruaja me dy identitete që premtun “shërim” me ujin e kufomave në Pejë



A ka Shqipëria një Nicola Gratteri?



Katër nëna në kërkim të fëmijëve/ Bisedat që zbuluan rrjetin e errët



Flamur Gjuzi, i dënuar për "shpërdorim detyre" sot drejtor i Policisë Bashkiake, sërish shkel ligjin?



Pallatet u zhytën“Durrës Marina” dhe Autoriteti Portual bëjnë veprimin e papritur përballë skandalit



Ekskluzive/ Nicola Gratteri çmonton skemën e pastrimit të parave të ndërtimit në Tiranë



PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 15



Enkel Demi duke luftuar paragjykimet për shqiptarët. (kamera e fshehtë)



Milva Ekonomi i firmosi miliona euro Vilma Nushit, kjo e fundit i investoi te kulla e Ervin Matës



Ajo çfarë mund të na mësojë Kosova.



Laboratorë “copy-paste”/ I njëjti mjek firmos analiza në disa pika, skema që ngre pikëpyetje



Rrjeti i ‘errët’ i vajzave të zhdukura! Bisedat tronditëse si funksiononte grupi.



Bleu 300 m2 tokë në vitin 2004, kthehet nga emigrimi dhe gjen aty vilë 3-katëshe.



“Na detyruan nga Dubai”/ Konstruktori i Durrës Marina zbulon pse u zhytën pallatet



Drejtori që tregon sjellje të pahijshme me nxënësen: Jam i fortë edhe në parti



PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 14



Turisti zemërgjerë nga Italia dhe patatinat falas



Aksidentet “pushtojnë” oborrin e familjes në Klos, banori: Një ditë do ndodhë tragjedi





Lidhja jashtëmartesore që përfundoi në makth /32-vjeçarja rrëfen shantazhin me video intime



Sherr në terminalin e Peshkopisë, shoferi: Mos më vidh pasagjerët! Shko ha bukë te pjesa jote



Artisti dhe Frika



Si u kthye në urrejtje dashuria mes ish-bashkëshortëve dhe 'lufta' për 200 mijë euro!



14-vjeçare me dr*gë dhepro*titucion, rrjeti i errët i minoreneve të zhdukura



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.